

V E N D I M
Nr.472, datë 12.2.2001

**PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT
PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË ZONAVE ZGJEDHORE**

Në mbështetje të neneve 71 dhe 72 pika 1 të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe të Ligjeve

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :**

I. Kthen për rishqyrtim Raportin Përfundimtar të Komisionit për Caktimin e Kufijve të Zonave Zgjedhore me rekomandimet bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raporti i Rishikuar për Caktimin e Kufijve të Zonave Zgjedhore duhet të paraqitet në Kuvend brenda datës 24.2.2001.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.